



Komuna e Lipjanit

Primi <sup>ljenje:</sup>	03.09.2021	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtoja Dodata
1-030-52698		



education code

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

mes

**KOMUNËS SË LIPJANIT**

dhe

**OJQ EDUCATION CODE**

për

**BASHKËPUNIMIN NË LIDHJE ME PROJEKTIN**

**"TË HESHTUR DHE TË HARRUAR"**

2021

# MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Ky Memorandum Mirëkuptimi (MM) i arritur në mes të:

**Komuna e Lipjanit – përfaqësuar nga Zt. Imri Ahmeti, Kryetar**  
dhe

**NGO Education Code – përfaqësuar nga znj. Mimoza K. Stanovci, Drejtoreshë**  
Ekzekutive.

Për te realizuar këtë, Palet kanë arritur mirëkuptimin si në vijim:

## 1. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti ka të bëjë me fuqizimin e Personave të Shurdhërve në Komunën e Lipjanit.

Projekti ka për qëllim të ngris kapacitetet e Personave të Shurdhër përmes avokimit, fuqizimit, trajnimit, dhe edukimit joformal të këtyre personave në Komunën e Lipjanit.

Arsyeja e këtij memorandumi / bashkëpunimi është, avokim në Komunën e Lipjanit për qasje më të madhe të personave të shurdhër në shërbime publike dhe administrative.

Konform ligjit dhe mundësive do të krijojë hapsirë për angazhimin / punësimin e një përsori interpreti për shërbime për Personat e Shurdhër në Komunën e Lipjanit.

## 2. Roli i NGO Education Code dhe Komunës së Lipjanit

- Komuna e Lipjanit nënshkruan memorandumin.
- Konform ligjit dhe mundësive të krijojë mënyrë për angazhimin/punësimin e një interpreti për shërbime për Personat e Shurdhër në Komunën e Lipjanit.
- Angazhimi/punësimi ka për qëllim assistimin e pësonave me aftesi të kufizuar respektivisht Personave të shurdhër të Komunës së Lipjanit, pasi që dihet se ky komunitet ka një shkallë të analfabetizmit duke mos ditur as shkrim lexim, deri në 97 %. Ky Memorandum i Bashkëpunimit ka për qëllim krijimine mundësive vetëm e vetëm të kenë qasje të barabartë me të gjitha komunitetet e tjera në këtë Komunë.
- NGO Education Code asiston dhe mbështetë trajnimin pësonave në të projektit "Të heshtur dhe të harruar" dhe pas përfundimit

- e) Identifikimin e personave të shurdhërve nga Education Code në Komunën e Lipjanit, dhe dörëzimi i raporteve përfundimtare në Komunën e Lipjanit.
- f) Education Code do të ofroj qasje në informata relevante të projektit pëngritjen dhe fuqizimin e Personave të Shurdhër në mënyrë sa më profesionale për Komunën e Lipjanit.


### 3. KOHËZGJATJA

- a) Ky Memorandum i Mirëkuptimit hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga ana e përfaqësuesve të autorizuar dhe do të zgjasë për të gjithë kohëzgjatjen e projektit.

### 4. TË NDRYSHME

- Në rast se ndonjëra nga Palët pengohet pjesërisht apo plotësisht në përbushjen e obligimeve që rrjedhin nga ky Memorandum si rrjedhojë e ndonjë veprimi të Fuqisë Madhore ose rrethana tjera jashtë kontrollit të Palëve, mos veprimi i ndonjërës nga Palët gjatë kësaj kohe e deri në përfundimin e ndikimit të tillë nuk do të konsiderohet si shkelje e këtij Memorandumi.
- Ky Memorandum nënshkruhet në mes Palëve me qëllim të zhvillimit ofrimit të qasjes dhe mundësisë së barabarta të personave të shurdhër dhe personave me aftësi të kufizuar.
- Në rast të mosmarrëveshjes, palët në rend të parë të provojnë të zgjedhin mosmarrëveshjen me diskutim të përbashkët. Në rast se mosmarrëveshje lidhur me këtë Memorandum nuk zgjidhet me diskutim të përbashkët brenda afatit prej 30 ditësh, nga data ku njëra nga Palët njofton Palën tjetër me shkrim mbi mosmarrëveshjen, atëherë Palët do ti referohen dhe çështja do të zgjidhet përfundimisht nga organet kompetente.
- Ky memorandum është i hartuar në gjuhën shqipe dhe është nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar e të dy Palëve me datën e shënuar më lartë, në katër kopje identike në gjuhën shqipe.

Për: Komunën e Lipjanit  
 Imri Ahmeti  
 Kryetar i Komunës



faqe 3 / 3

Për: NGO Education Code  
 Mimoza K. Stanovci  
 Drejtoreshë Ekzekutive

